REPUBLIKA E KOSOVËS/REPUBLIKA KOSOVA/REPUBLIC OF KOSOVO
KUVENDI KOMUNAL/ASSAMBLY OF MUNICIPALITY/SKUPŠTINA OPŠINA
SKENDERAJ
Nr. No. 02-052/01-0024764/26
Data Data 03-07-2026

Republika e Kosovës
Republika Kosova
Republic of Kosovo

Komuna Skenderaj
Opština Skenderaj
Municipality of Skenderaj

Procesverbal i Takimit të Parë Publik, të vitit 2026, i mbajtur nga Kryetari i Komunës së Skenderajt Sami Lushtaku

Me datë 30 qershor 2026 është mbajtur takimi i parë publik, i thirrur me datë 10 qershor 2026 nga Kryetari i Komunës. Ky takim u mbajt në sallën e Kuvendit Komunal, ku morën pjesë Kryetari i Komunës z.Sami Lushtaku, drejtorët e drejtorive si dhe qytetarë të Komunës së Skenderajt.

Data: 30.06.2026

Ora: 14:00

Vendi: Salla e Kuvendit Komunal, kati IV

Të pranishëm: Kryetari i Komunës, z.Sami Lushtaku, drejtorët komunal, qytetarë të Komunës së Skenderajt.

Kryetari: Përshëndetje për të gjithë, faleminderit që keni gjetur kohë sot me ardhë në këtë takim publik, i pari për këtë vit. Gjatë këtij gjashtë mujori të parë si Komunë kemi vazhduar me projektet që kanë qenë në realizim dhe kemi filluar edhe me projekte të reja të cilat do të realizohen në ditët në vazhdim, gjithmonë brenda mundësive dhe kapacitetit buxhetor që kemi si Komunë. Për me shumë detaje, këtu i kemi edhe drejtorat e drejtorive të cilët do t'i shfaqin para juve këto projekte dhe pastaj do të keni mundesinë edhe ju për t'i shtruar pyetjet dhe kërkesat që i keni si qytetarë.

Ia kaloj fjalën drejtorit të financave dhe pastaj drejtorit të urbanizmit, që të tregojnë për punët, vazhdimin e punëve dhe për projektet që po bëhen në Komunën e Skenderajt.

Behxhet Maliqi – DFB: Fjala përshëndetëse, është takimi i parë publik i Krytearit të Komunës, i cili përfshinë periudhën raportuese për 6 mujorin e parë të vitit 2026. Në këtë periudhë vlen të cekët që është bërë një punë e jashtëzakonshme brenda mundësive financiare dhe përkrahjeve buxhetore që i ka pasur Kuvendi Komunal i Skenderajt. Një pjesë e madhe e projekteve janë në vazhdimësi, por është edhe Drejtori i Urbanizmit dhe drejtorët tjerë këtu që do t'i prezantojnë me hollësisht para jush. Një punë e jashtzakonshme është bërë edhe nga Drejtoria e Financave më zyrtarët e saj sidomos në Hartimin e Pasqyrave Financiare dhe në përgjithësi punën në Raportin e Auditimit të Pasqyrave Financiare. Drejtoria e Financave ka qenë e angazhuar në këtë 6 mujor në një dokument tjetër strategjik që është KAB, e hartuar në bashkpunim me drejtoritë dhe me qytetarët pjesëmarrës në dëgjimet publike dhe gjithashtu i ka kaluar të gjitha fazat si KPF dhe asamblenë dhe tani është për aprovim në Qeverinë e Kosovës. Këto janë aktivitetet e Drejtorisë së Financave në pika të shkurtra, duke përfshirë edhe mbështetjen e drejtorive tjera në aspektin financiar.

Për më shumë, fjalën ia kaloj drejtorit të urbanizmit, që të flas me konkretisht për projektet që janë duke u realizuar dhe që do të realizohen në Skenderaj.

Faleminderit shumë të gjithve për pjesëmarrjen në takim, jam i hapur për pyetje, sugjerime për çkado që mund të keni për këtë raportim 6 mujor.

Arbnor Çitaku- Drejtoria e Urbanizmit: Fjala përshëndetëse. Drejtoria e Urbanizmit, në kuadër të kontratave që ka pasur janë kontrata që kanë vazhduar si: asfaltimi dhe kubëzimi i rrugëve në qytet, me intesitet të shtuar kanë filluar punimet në Subqendrën e Çirezit, pastaj Subqendra në Likoc, në Runik, në Klinë të Epërme, kanalizimi në Turjan të fshatit Vajnikë, ujësjellësi në Bashkësinë Lokale të Çirezit, Muzeu dhe Biblioteka e qytetit, po ashtu ka vazhduar mbjellja e drunjëve dhe këndet gjelbëruese në qytet, ndërtimi i urave në fshatin Aqarevë dhe në Kuqicë.

Këto ishin disa nga punët të cilat Drejtoria e Urbanizmit i ka punuar gjatë këtij 6 mujori në 6 mujorin e dytë do të vazhdojmë edhe me punët e tjera të cilat i kemi si vazhdim i kontratave aktuale, por edhe të kontratave të reja.

Sami Lushtaku – Kryetari i Komunës: Faleminderit drejtor. A ka dikush nga qytetarët ndonjë pyetje?

Sejdi Bajraktari- fshati Likoc i Ri: Fjala përshëndetëse. Ne kemi problem me kanalizim, që ka shpërthyer që 1 vit e gjysmë vjen nga fshati Likoc tek ne. Kemi qenë disa herë në Drejtorinë e Shërbimeve Publike, jo nuk na kan thënë asnjëherë por problemi nuk është zgjidhë ende. E kam edhe një video nëse mundeni me pa. Problem e kemi erën që shkakton ky shpërthim i kanalizimit.

Sami Lushtaku – Kryetari i Komunës: A ke ndonjë pyetje tjetër?

Sejdi Bajraktari- fshati Likoc i Ri: Tjetër problem e kemi ndriçimin. Në fshatin Makermal dhe Likoc, ndërsa Likoci ri është anashkalu. Tjetër problem është me trotuar për nxënësa, pra kemi nevojë për trotuar. Nuk kam diçka tjetër.

Sami Lushtaku – Kryetari i Komunës: E di për problemet në fshatin Likoc të ri, mirëpo buxheti i Komunës është ky që është, e di që problemin më të madh momentalisht Komuna jonë e ka me kanalizim dhe me ujë të pijshëm. Uji i pijshëm, furnizmi me ujë nuk është në dorën tonë, ne si Komunë kemi shtruar shumë gypa, mirëpo kompania rajonale e ujësjellësit është përgjegjëse për furnizmin me ujë pra ajo që duhet të kujdesët për ujin e pijshëm edhe në Komunën e Skenderajt.

Ndërsa sa i përket trotuarit dhe ndriçimit, ne jemi duke vazhduar pothuajse në të gjitha fshatrat, nuk po jap datë por brenda mundësive buxhetore që i kemi me siguri që do e zgjedhim edhe këtë problem. Ndërsa për trotuar e kemi këtu edhe Drejtorin e Urbanizmit dhe të përgjigjet.

Sejdi Bajraktari- fshati Likoc i Ri: për momentin, problemin numër një e kemi kanalizimin që ka shpërthy.

Sami Lushtaku – Kryetari i Komunës: E di që kemi probleme, mirëpo e di që është në procedurë një tender për zhbllokimin e kanalizimeve, por një problem të madh kemi edhe me disa qytetarë të cilët janë të pakujdeshshëm në veprimet e tyre.

Sejdi Bajraktari- fshati Likoc i Ri: kanalizimi ka nevojë një anashkalim me i bë, me ja ndrru kahjen, sepse nuk ka ramje fare dhe po del jashtë në sipërfaqe.

Sami Lushtaku – Kryetari i Komunës: Drejtori pëgjigjët më hollësisht. Kisha pas dëshirë kështu me qenë qytetarë sa më shumë edhe për ne është më mirë kur marim vërejtje dhe kritika për problemet që i ka secili fshat edhe pse ne i dimë pjesën me të madhe të tyre por me siguri që nuk i dimë të gjitha.

Fjalën ja kaloj drejtorit.

Arbnor Çitaku- Drejtoria e Urbanizmit: Sejdi, për pjesën e kanalizmit kemi diskutu disa herë edhe me herët se bashku, kam thënë që ne e kemi një kontratë që jemi duke e përgatit dhe besoj që shumë shpejt do të përfundohen procedurat e prokurimit dhe do të vazhdojmë me kanalizime, jo vetëm të ju por edhe ne fshatrat tjera, sepse kërkesat janë të jashtëzakoshme, janë mbi 5-6 kërkesa në ditë për kanalizim, sidomos në këtë kohën e nxehtë që jemi tash.

Sami Lushtaku – Kryetari i Komunës: Falemiderit drejtor. Dikush tjetër?

Hamdi Shabani: Fjala përshëndetëse.Unë e kam një kërkesë për Palestrën Sportive "Ilaz Kodra" janë disa punë që duhet me u kry, pasiqe i kemi dy klubet Futsallin dhe Volejbollin që t'i ken disa kushte më të mira për të ardhmen. E di që edhe buxheti i Komunës është i limituar, por sipas mundësive.

Sami Lushtaku – Kryetari i Komunës: Unë, ti, një pjesë e ekipit, takimin që e kemi pasur bashkë, ne kemi premtu që gjithçka që është në mundesitë tona do ta bëjmë, sepse është në interes të Komunës tonë që të zhvillohen lojërat ndërkombëtare në Skenderaj.

Klubi i Futsallit Drenica, na ka bërë të gjithëve të ndihemi mirë dhe shpresoj që problemet që janë brenda Palestrës Ilaz Kodra kemi me i zgjidhë.

Sami Lushtaku – Kryetari i Komunës: A ka dikush tjetër diçka?

Ganimete Syla Thaçi: Unë jam e interesuar për punësim, e kam të përfunduar Fakultetin e Gjuhës dhe Letërsisë Shqipe, deshta me ditë, a ka ndonjë konkurs?

Sami Lushtaku – Kryetari i Komunës: Faleminderit. Ka shumë kërkesa për punësim. Vullneti dhe dëshira jonë është që t'u hapim dyert të gjithve, që të gjithë qytetarët të kenë punësim. Konkurset janë publike, i dini edhe ju, mirë është me konkuru dhe me i ndjekë procedurat që janë të nevojshme dhe t'i plotesojnë kriteret e kërkuara secili aplikant, sipas konkurseve që bëhen publike në faqe të Komunës.

Sami Lushtaku – Kryetari i Komunës: A ka dikush diçka tjetër?

Sami Lushtaku – Kryetari i Komunës: Nëse jo, atëherë edhe njëherë dua t'iu falënderoj që jeni me neve. Mirë është kur qytetarët interesohen për problemet dhe hallet që i kanë në fshatrat dhe lagjet e tyre edhe pse ne i dimë një pjesë të madhe të tyre.

Faleminderit shumë prej të gjithve. Me kaq e mbyllim këtë takim. Shihemi në takimet tjera.

Procesmbajtësi: Besjana Thaçi

Foto nga takimi i parë publik me qytetarë, 30.06.2026, Salla e Kuvendit Komunal, mbajtur nga Kryetari i Komunës Sami Lushtaku





Lista e nënshkrimeve të pjesëmarrësve nga takimi i parë publik 2026 i mbajtur nga kryetari i komunës.
Vendi: Salla e Kuvendit Komunal, kati IV

Datë: 30/06/2026

Ora: 14:00

Emri	Mbiemri	Nënshkrimi
IDMET	ZABELI	
Hakë	Gashi	
Shaban	Shaqiri	
LIRIDON	SHAJLI	
Hamdi	Topallaj	
Dauto	Uka	
QENDRIM	ZABELI	
Zela	Hakolli	
Vjollca	Selmani	

Lista e nënshkrimeve të pjesëmarrësve nga takimi i parë publik 2026 i mbajtur nga kryetari i komunës.
Vendi: Salla e Kuvendit Komunal, kati IV

Datë: 30/06/2026

Ora: 14:00

Emri	Mbiemri	Nënshkrimi
ABDULLA	GASHI	
HAMDI	SHABANI	
Shqipdona	Rama	
Mentinda	Dengjuli	
Redona	Shala	
Refsen	Dauti	
Leonard	Mehmetaj	
Diedon	Rushiti	
Dardan	Imeraj	
ADELI	MUHARREMI	
Yejdi Bajraktari	Bajraktar	
HALIL	XANI	
Ylli	Medini	
AERON	ISTOGU	
RESART	GECI	

Lista e nënshkrimeve të pjesëmarrësve nga takimi i parë publik 2026 i mbajtur nga kryetari i komunës.
Vendi: Salla e Kuvendit Komunal, kati IV

Datë: 30/06/2026

Ora: 14:00

Emri	Mbiemri	Nënshkrimi
Fazile	Hajraj	
Natyra	Thaçi	
Elena	Gashi	
Arnisa	Kadriu	
Enza	Veliu	
Dejanet	Thaçi	
Hasan	Krasniqi	
DERVISH	SHALA	D.SH
Besarta	Hasani	
Petrit	Bela	
ARIZONA	DAJAKU	
Lindita	Veseli	
Hatije	Coli	

Lista e nënshkrimeve të pjesëmarrësve nga takimi i parë publik 2026 i mbajtur nga kryetari i komunës.
Vendi: Salla e Kuvendit Komunal, kati IV

Datë: 30/06/2026

Ora: 14:00

Emri	Mbiemri	Nënshkrimi
KUSHTRIM	DRAGAJ	
Ramadan	Hoxhaj	
Ganimete	Syla Thaçi	Syla Thaçi
Antigona	Maliqi	
Vjosa	Bigbaj Vojvoda	
[illegible]	[illegible]	
Antigona	Mjftari	
Getoarba	Prokshaj	
Behije	Lushtaku	B Lushtaku
EDONA	BOXHOLI	
Arta	Veseli-Muriqaj	
Morgjana	Ahiqaj	
GAZMI	KEROLLI	
MIRADIJE	BULIQI	
Zahide	Veliu	

Nr. 02-060/01-0021510/26
Data 10 06 2026

Republika e Kosovës
Republika Kosova
Republic of Kosovo

Komuna Skenderaj
Opština Skenderaj
Municipality of Skenderaj

Zyra e Kryetarit /Kabinet Predcednika / Office of the Mayor

Duke u bazuar në nenin 68 të Ligjit Nr.03/L-040 për Vetëqeverisjen Lokale, ndërlidhur me nenin 6 të Rregullorës për Transparencë në Komunën e Skenderajt Nr.01-110/01-0047004/20, të datës 02.11.2020, si dhe nenin 67 të Statutit të Komunës së Skenderajt Nr.01-110-385 të datës 03.12.2008, Kryetari i Komunës fton:

TAKIM PUBLIK

Më datën 30.06.2026, në ora 14:00, në sallën e Kuvendit Komunal të Komunës së Skenderajt

I ftohën qytetarët e Komunës së Skenderajt që më datën 30.06.2026 (e martë), në ora 14:00, në sallën e Kuvendit Komunal të Komunës së Skenderajt, të marrin pjesë në takimin e parë publik për vitin 2026.
Në këtë takim, qytetarët do të informohen nga përfaqësuesit komunal për aktivitetet dhe punën e Komunës, si dhe do të kenë mundësi të parashtrojnë pyetje dhe të japin propozime për përfaqësuesit e zgjedhur komunal, lidhur me çështjet me interes për qytetarët.

Kryetari i Komunës
Sami Lushtaku